

ETIKA DHE DILEMAT E SAJ NË INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT

nga Albana AGOLLI – Drejtore Departamenti¹,

botuar në gazetën “Ekonomia”, më 10 qershor 2014.



Etika ndihmon që të gjithë anëtarët e stafit të Institucioneve Supreme të Auditimit të përcaktojnë rolin dhe përgjegjësitë, kjo në lidhje me vetveten, me kolegët, me partnerët apo me subjektet që auditohen. Sjellja etike nuk është një proces pasiv, por kërkon që nga anëtarët e stafit të SAI-t të bëhen zgjedhje të ndërgjegjshme, të merren vendime të tilla, sidhe të ketë gjykim të shëndoshë në përputhje me vlerat etike, që materializohen në Kodin Etik.

Në bazë të Deklaratës së Limës mbi Udhëzuesit e Auditimit, Kodi i Etikës së INTOSAI-t, duhet të shihet si një plotësim i domosdoshëm, duke përforcuar standardet e auditimit të INTOSAI-t, të Komitetit të Standarteve të Auditimit, Qershor 1992.

Në një SAI, shqetësimet kryesore në lidhje me etikën dhe kodin etik, janë ato vlera dhe parime të cilat duhet të udhëheqin punën e përditëshme të audituesve dhe që kanë të bëjnë me konfliktin e interesave, me pavarësinë, paanshmërinë, dhuratat dhe mikpritjen, paanshmërinë politike si dhe me ruajtjen e sekretit profesional. Është përgjegjësi e SAI-t të zhvillojë Kodin e tij në përshtatje me mjedisin.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke qenë anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), ka Kodin e tij Etik, i cili bazohet në Kodin Etik të INTOSAI-t, si dhe në legjislacionin në fuqi për rregullat e etikës në administratën publike.

Bazuar në Kodin Etik, audituesit duhet të sillen në mënyrë që të promovojnë bashkëpunim si dhe marrëdhënie të mira mes tyre dhe brenda profesionit. Integriteti është vlera kryesore e Kodit të Etikës. Çdo auditues, kur zbaton detyrat e ngarkuara, duhet t'i përmbahet standardeve të larta të sjelljes, të veprojë gjithnjë me ndershmëri, profesionalizëm, objektivitet, me përkushtim dhe me paanshmëri.

Eksperiencia ndërkombëtare

Shpërndarja e eksperiencave dhe njohurive për auditimin dhe etikën, është një nga bazat e grupit Task Forcë të EUROSAI, (TFA&E). Kjo Task Forcë është një strukturë e krijuar nga bordi drejtues i EUROSAI-t, ku KLSH është pranuar anëtar në Qershor të vitit 2013. Një nga objektivat kryesore të saj është “Kontributi për të rritur besimin e publikut në punën e SAI-ve, nëpërmjet implementimit të ISSAI 30, Kodi i Etikës”. *Kodi i etikës është një deklaratë gjithëpërfshirëse e vlerave dhe parimeve, të cilat duhet të udhëheqin punën e përditëshme të audituesve, gjë që arrihet me një funksionim sa më efektiv të infrastrukturës etike.*

Një nga objektivat e TFA&E, është mbështetja e SAI-ve europiane në zbatimin e kërkesave etike të identifikuara dhe të përcaktuara për çdo SAI.

Dilemat etike brenda SAI-ve dhe si t'i trajtojmë ato.

Dilemat etike tipike të SAI-ve, veçanërisht për SAI-t e vendeve të vogla, siç është edhe KLSH, janë marrëdhëniet me subjektet e audituara, lidhjet familjare, interesat financiare, pronat, aktivitetet profesionale të partnerit apo bashkëshortit. Një dilemë e fortë është pjesëmarrja në auditimet, ku audituesi ka anëtarë të familjes (bashkëshorte dhe/ose të afërm), si punonjës në këtë subjekt. Dilema paraqesin edhe marrëdhëniet me subjektet e audituara, familjarizimet, marrëdhëniet e mëparshme të punës, auditimi në të njëjtin subjekt në mënyrë të përsëritur apo në subjektet ku audituesi ka punuar më parë, konsulenca, funksione në organizata që marrin fonde nga financat publike, etj. Dilema të tjera për etikën në Institucionet Supreme të Auditimit, janë ato që kanë të bëjnë me pranimin e dhuratave apo favorizimeve nga subjektet e audituara ose furnizuesit, si dhe paanshmëria politike, opinionet politike, pjesëmarrja në çështjet e diskutueshme publike ose politike, pranimi i posteve politike, në pushtetin qendror apo lokal.

Format si të indukojmë një kulturë etike, sipas përcaktimit të Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA), janë: fryma etike e menaxhimit të lartë (Tone at the top); trajnimet e udhëzimet; komunikimi dhe monitorimi.

Përsa i përket praktikave të menaxhimit, nuk mund të evitohet vënia e theksit tek rëndësia e shembullit personal të drejtuesit. Kështu, në standardin ISSAI 40, Kontrolli i Cilësisë së SAI-ve, thuhet se *“Drejtuesi i SAI-t dhe personeli me përvojë brenda SAI-it duhet të shërbejnë si shembull i një sjellje etike të përshtatshme”*.

Kuadri etik shihet i përbërë nga një nivel bazë rregullash etike dhe standarte, si dhe nga niveli më i lartë, ku vetë fryma e institucionit i orienton drejt rrespektimit të vlerave dhe parimeve dhe një kulture të lartë etike.

Kërkesat etike të vendosura nga ISSAI udhëzojnë veçanërisht se SAI duhet të sigurojë transparencën dhe ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe se drejtuesit duhet të jenë shembuj të sjelljes etike të përshtatshme. Sjelljet e mira nga drejtuesit, trajtimi i drejtë dhe marrëdhëniet e mira ndërmjet kolegëve janë një kontribut i rëndësishëm për vetëdijen e moralit të stafit si dhe ndihmojnë për të promovuar një qëndrim etik ndaj punës dhe integritet të stafit në vendin e punës.

Në “Udhëzuesin praktik për Etikën dhe Sjelljen e Stafit” të Komisionit Europian, përcaktohet se, në përpjekje për të zgjidhur dilemat e mundshme etike, të cilat mund të lindin kur vlerat dhe parimet vijnë në konflikt me njëri-tjetrin, duhet të analizohet situata duke parë faktet, rrethanat dhe rregullat përkatëse, me qëllim identifikimin e opsioneve të mundshme; duhet të konsiderohen pasojat e opsioneve të ndryshme, si dhe e të mos vepruarit; të verifikohen nëse edhe të tjerët pajtohen me opsionet e identifikuara apo ka alternativa; të ndërmerren veprime në bazë të mundësive më të mira të identifikuara si dhe të vlerësohen ndikimi i veprimit dhe ndonjë opinion lidhur me të, pasi një eksperincë e tillë mund të shërbëjë si precedent apo si një pikënisje për përballimin e situatave të ngjashme në të ardhmen.

Sfidat e KLSH për auditimin e etikës në të ardhmen

Vizioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin e etikës dhe integritetit në organizatat e sektorit publik është që jo vetëm të vlerësojë mjedisin dhe infrastrukturën etike në njësitë e sektorit publik por dhe të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit, kontrollit dhe mirë qeverisjes së njësisive të audituara nëpërmjet adresimit të rekomandimeve dhe ndjekjes së zbatimit të tyre.

Si çdo SAI, edhe KLSH ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjithë anëtarët e stafit të tij të njihen me vlerat dhe parimet që përmban Kodi i Etikës dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat. Zbatimi i Kodit Etik për audituesit, promovon besimin në punën e tyre. Kjo gjë është arritur në vitet e fundit dhe është në vëmendjen maksimale të menaxhimit të lartë, pasi është e një rëndësie themelore që KLSH të shihet me besim dhe kjo arrihet duke ndërgjegjësuar stafin për çështjet e etikës, duke rritur angazhimin e drejtuesve, zhvillimi i aktiviteteve profesionale të tilla si edukimi, trajnimi dhe këshillimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të zhvilluar

aftësitë për zbatimin e ligjeve dhe standarteve, duke zbatuar parimet themelore të etikës profesionale, të koncepteve të integritetit, pavarësisë, objektivitetit, paanshmëria, sekretit profesional dhe kompetencës, përkufizuar në ISSAI 30.

Vetëm në këtë mënyrë, KLSH mund të ndikojë dhe të gjenerojë produktivitet në drejtim të implikimeve dhe influencave që ka etika në arritjen e objektivave, misionit dhe vizionit për të ardhmen e njësive të sektorit publik.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Albana AGOLLI për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *Suporti ndaj KLSH – mbështetje mirëqeverisjes financiare të Shtetit.*

(Botuar në gazetën “Ekonomia”, më 15 qershor 2014.)